


## THIRRJE PER TRAJNERE

**Qendra për të Drejtat në Punë, CLR** me qëllim zgjerimin e grupit të trajnerëve të Akademisë së Punës, AP hap këtë thirrje për aplikim për pozitën e *trajnerit/es*.

**Akademia e Punës-AP** e krijuar në vitin 2018, ofron formim nëpërmjet trajnimit dhe vetëdije për të drejtat e punës. AP synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e njohurive të anëtarëve të grupeve të interesit mbi të drejtat e punës, duke nxitur ndryshime thelbësore në lëvizjen e punës në Shqipëri.

**Përfituesit** kryesor të këtij programi trajnimi të Akademisë së Punës janë këto kategori: Drejtues të Sindikatave në nivele të ndryshme, drejtues të institucioneve, menaxherë të partive politike, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, aktorë të shoqërisë civile të cilët operojnë në botën e punës, dhe individë të interesuar, punonjës, aktivistë shoqëror, institucionet lokale dhe rajonale dhe palët e tjera të interesuara për botën e punës.

**Struktura e AP konceptuar** në formën e një **Piramide**, bazuar në target grupe (grupet e synuara), përfshin të gjitha nivelet e grupeve të interesit lidhur me punën dhe të drejtat në punë. Në këtë piramidë, secili nivel përfaqëson një grup të caktuar të synuar dhe përputhet me hierarkinë e tyre në kontekstin e çështjeve të punës. Kjo piramidë stukturore përfshin:



Detyrat kryesore të pozitës së trajnerit/es përfshijnë:

- Zhvillimin e materialeve trajnuese në përputhje me tematikat specifike të kurrikulës së AP;
- Mbajtjen e sesioneve trajnuese dhe ndihmën në aftësimin e pjesëmarrësve;
- Monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të pjesëmarrësve gjatë programit;
- Bashkëpunimin me ekipin e Akademisë së Punës për përmirësimin e programit.

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare (niveli Master) në fushat e lidhura me tematikat e AP;
- Të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e drejtave të punës;
- Përvojë e mëparshme në mbajtjen e tranimeve;
- Aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Njohuri të kënaqshme të gjuhës angleze.

**Tematikat e AP:**

**Tema 1.** Si të Organizohemi - Manual në ndihmë të fushatave për organizimin e sindikatës NË VENDIN E PUNËS dhe shtimin e numrit të ANËTARËVE

**Tema 2.** Çfarë është dhe çfarë nuk është sindikalizmi; E drejta për tu Bashkuar dhe Krijuar Organizata Sindikale

**Tema 3.** Koncepti i Udhëheqjes – Liderhipi sindikal

**Tema 4.** Hyrje në marrëveshjet kolektive të punës

**Tema 5.** Negocimi, procesi dhe Aftësitë negociuese të nevojshme

**Tema 6.** Advokatësia dhe Lobimi

**Tema 7.** Dialogu Social Evropian

**Tema 8.** Marrëdhëniet dypalëshe/dialogu social- shoqëror; Marrëdhëniet punëdhënës – punëmarrës në vendin e punës

**Tema 9.** Aksioni Sindikal - format

**Tema 10.** Zgjidhja paraprake e mosmarrëveshjeve kolektive

**Tema 11.** Mbrojtja dhe siguria në vendin e punës

**Tema 12.** Menaxhimi organizativ dhe financiar i një organizate sindikale

**Tema 13.** Media, Teknologjia e Informacionit dhe Sindikatat

**Tema 14.** Sindikata dhe partitë politike, **sfidat e bashkëpunimit**

**Tema 15.** Politikat e punësimit në Shqipëri dhe integrimi Evropian, roli i aktorëve

**Tema 16.** Barazia Gjinore dhe diskriminimi në vendin e punës

**Tema 17.** Komunikimi përmes prespektivës gjinore - të vërtetat pas diskriminimit gjinor

Për të aplikuar për pozitën e trajnerit, ju lutemi të dërgoni **CV-në tuaj** dhe një **letër motivimi** ku specifikoni tematikën/at për të cilat po aplikoni, në adresën [info@clr.al](mailto:info@clr.al) me subjekt: **Aplikim për Trajner - AP**. Afati i aplikimit: **15.02.2024**.

Aplikimet e ardhura pas këtij afati nuk do të merren në konsideratë.